

## Kategoria Superiore/ Bylis – Kastrioti 1-0

nga AlbaniaSoccer

E shtunë, 14 Shtator 2013 17:03

---



Bylis ka gjetur fitoren e pare ne Superiore ne ndeshjen e pare te luajtur ne shtepi. Nje gol i nigerianit Izucuku i ka dhene ballshioleve te drejten per te festuar suksesin e pare qe ka sjelle dhe tre piket e para ne kampionat. Kastrioti ka qene i pafuqishem per te marre nje rezultat pozitiv ne nje ndeshje te luftuar shume ne mesfushe. Ballshiotet kane bere mjaft mire duke vrapuar me shume se miqte nga Kruja dhe ne fund jane shperblyer. Kastrioti pas kesaj humbje mbetet ne kuoten e zero pikeve ndersa Bylisi merr tre te parat ne Superiore.